



VENDIM

Nr. 110 Datë 01.10.2013

PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “STRAVAJ”
SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 01.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “STRAVAJ ENERGY” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “STRAVAJ” si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “STRAVAJ ENERGY” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**

Pershkrimi i pergjithshem i centralit.

Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.

- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e pergjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion eshte paraqitur ne menyre korrekte.

- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**

Pershkrimi i centralit..

Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi :

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “STRAVAJ”, si burim i rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim Bozgo**